



# Ardian Myslimaj

Këshilltar

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Z. Ardian Myslimaj ka përfunduar Akademinë Ushtarake në vitin 1991, më pas ka kryer studimet për Drejtësi në Universitetin e Tiranës duke u diplomuar si "Jurist" në vitin 2008.

Gjithashtu, në vitin 2022 ka përfunduar studimet e thelluara pasuniversitare në fushën "Studime Evropiane". Gjatë karrierës ka ndjekur trajnime të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare për rritjen e kapacitetit profesional në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes, si p.sh Kursin e Lartë Ekzekutiv në Qendrën "G.Marshall" në Gjermani.


Z. Myslimaj mban titullin "Prof. Asoc. Dr."


Gjatë eksperiencës së tij z. Myslimaj ka punuar pedagog në Akademinë Ushtarake në vitin 1991-1992. Nga viti 1993-1997, ka punuar si gazetar. Ka qenë deputet në Kuvendin e Shqipërisë nga viti 1997-2005. Më pas, 2007-2014 ka punuar në Universitetin Ushtarak dhe Akademinë e Mbrojtjes "Spiro Moisiu".


Gjatë periudhës 2016-2021 ka punuar si administrator i Qendrës për Regjistrimin e Aksioneve në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Marrëdhëniet e punës në Kontrollin e Lartë të Shtetit i ka filluar në mars të vitit 2021 si Këshilltar në Kabinetin e Kryetarit të KLSH-së, detyrë të cilën e mban edhe aktualisht.

## Kontakt

 [amyslimaj@klsh.org.al](mailto:amyslimaj@klsh.org.al)

 Rruga "Abdi Toptani", Tiranë  
Shqipëri

 [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)